

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 15, paragrafi (1) dhe neni 29 të Ligjit për Mediume ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13 dhe 13/14 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.63/24, 74/24, 218/24 dhe 87/25), pika 7 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 të datës 1.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.03-1973/1 të datës 30.4.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2165/3 të datës 20.5.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale gjatë seancës së 18-të të mbajtur më 20.5.2026 miratoi:

**Aktvendim
për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËRON Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive (ShTR) 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, për shkeljen e kryer të nenit 15, paragrafi (1) të Ligjit për Mediume (LM), për mënyrën që transmetuesi nuk ka dorëzuar në Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) dokument për regjistrimin e personit të huaj juridik, themelues i transmetuesit, nga regjistri përkatës i vendit në të cilin është regjistruar, nga i cili mund të merren informata për themeluesin/it dhe drejtuesin (jo më i vjetër se shtatë ditë nga dita e dorëzimit, në origjinal dhe të përkthyer në gjuhën maqedone nga përkthyes i autorizuar gjyqësor).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr.ark.03-1973/1 të datës 30.4.2026, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi me Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LM-së.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, do të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

A r s y e t i m

Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia), në bazë të nenit 29 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për mediume (LM) është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave në aspekt të harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e neneve 6, 8, 14 dhe 15 nga LM.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias ndërmerr masë – paralajmërim publik në pajtim me Ligjin, në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LShMAAV-së dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29, paragrafi (2) të LM-së, masat që Agjencia si trup rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë dhe që janë të përcaktuara në LShMAAV-së, zbatohen në mënyrë adekuate dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM-së.

Në pajtim me nenin 15, paragrafi (1) të LM-së, transmetuesit janë të detyruar deri më 31 mars të vitit aktual në formularë të veçantë të përcaktuar nga trupi rregullator kompetent të paraqes të dhëna për: strukturën pronësore përkatësisht të dhëna për emrin dhe selinë e personave juridik ose emrin dhe vendin e banimit të personave fizik që janë pronarë të aksioneve ose pjesë tek botuesi i medias, me të dhëna mbi përqindjen e aksioneve ose pjesës së fituar dhe datën e blerjes, të dhëna për redaktorin përgjegjës/redaktorët, të dhëna mbi burimet financiare të transmetuesit në vitin paraprak (reklama, sponsorizim, shitje të përmbajtjeve, shërbime të ofruara palëve të treta, dhe të ngjajshme), të dhëna mbi të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në total të transmetuesit në vitin paraprak nga ushtrimi i veprimtarisë dhe të dhëna mbi shikueshmërinë ose dëgjueshmërinë mesatare të transmetuesit në vitin paraprak.

Në kuadër të kompetencave të sal ligjore, Agjencia përmes Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit më 30 prill 2026, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative ndaj ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, ku është konstatuar shkelje e nenit 15, paragrafi (1) i LM-së.

Nga mbikëqyrja e rregullt është konstatuar se ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, nuk ka përbushur plotësisht detyrimin nga neni 15, paragrafi (1) të LM-së, përkatësisht nuk i dorëzoi Agjencisë dokument për regjistrimin e personit juridik të huaj, themelues i transmetuesit nga regjistri përkatës i vendit në të cilin është regjistruar nga i cili mund të merren informata për themeluesin/it dhe drejtuesin (jo më i vjetër se shtatë ditë nga dita e dorëzimit, në original dhe të përkthyer në gjuhën maqedone nga përkthyes i autorizuar gjyqësor).

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikura në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.03-1973/1 të datës 30.4.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë drejtuar ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip më 4.5.2026, dërgoi Shkresë nr.ark.03-1973/2 datë 4.5.2026, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.03-1973/1 të datës 30.4.2026, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM-së. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 6.5.2026. Në afatin e parashikuar, ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 20.5.2026, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim konkludoi që ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip t'i shqiptohet masë – paralamërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV-së dhe në lidhje me nenin 15, paragrafi (1), dhe neni 29 i LM-së, pika 7 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.03-1973/1 të datës 30.4.2026, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LM-së, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 18-të të mbajtur më 20.5.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-2165/3 të datës 20.5.2026, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip dhe urdhëroi që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LM-së. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, Agjencia do të kryejë me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes, cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi botuesi i mediumit (transmetuesi) ka të drejtë padie për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë të ngrejë pafdi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative nr.ark.03-1973/1 të datës 30.4.2026.

Përktheu: Antonet Shabani